



VERTIKOLL C1TE

Ngjyra	Paketimi	Konsumi
Bardhë, Gri	Thes 25 kg	3-5 kg/m ²



PËRSHKRIM

Ngjitës për pllaka me bazë çimento (C), me forcë ngjitëse normale (1) dhe rezistent ndaj rrëshkitjes (T) dhe kohë punueshmërie të gjatë (E). Karakterizohet nga një punueshmëri shumë e mirë, rezistencë të mirë ndaj lagështisë, kohë optimale korrigjimi dhe fortësi të njëtrajtshme. I klasifikuar si ngjitës C1TE sipas standartit EN 12004.

FUSHA E APLIKIMIT

I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave të qeramikës, gres-porcelanit, për dysheme dhe mure në ambiente të brendshme me bazë çimento. I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave me dimensione 5-50 cm.



MENYRA E PËRGATITJES SË PËRZIERJES

Përzieri 6-6.5 litra ujë të pastër me 25 kg VERTIKOLL, përzieri masën e krijuar me një përzierës elektrik derisa të formohet një masë homogjene dhe pa kokrriza. Lëreni në qetësi për 10 minuta dhe më pas përziejini përsëri përpara përdorimit. Koha e punueshmërisë së përzierjes është 2-3 orë.



PËRGATITJA E SUPORTIT

Të gjitha tipet e suporteve me bazë çimento duhet të pastrohen paraprakisht përpara se të aplikohet produkti. Suporti mund të përmbajë papastërti të tilla si pluhura, vajra apo mbetje të ndryshme të cilat ndikojnë negativisht në forcën ngjitëse të produktit. Pastrimi mund të bëhet në mënyrë mekanike. Përpara aplikimit të produktit sipërfaqja e suportit duhet të spërkatet me ujë në mënyrë që produkti të krijojë një ngjitje sa më të mirë dhe të ketë një kohë punueshmërie sa më optimale.

APLIKIMI

Fillimisht produkti rekomandohet të shtrohet me pjesën e drejtë të mallës për të pasur një shpërndarje sa më të njëtrajtshme dhe më pas me pjesën e dhëmbëzuar. Aplikimi bëhet me një mallë të përshtatshme në varësi të llojit të pllakës që shtrohet. Vendosja e pllakave bëhet duke ushtruar një presion të vogël mbi pllakë duke u siguruar që pllaka të mbulohet në të gjithë sipërfaqen me kollë. Konsumi 3-5 kg/m² sipas dimensioneve të dhëmbëzimit të shpatullës dhe tipit të bazamentit.



TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja:	Pluhur
Paketimi:	Thes letre 25 kg në paleta 1350 kg
Ngjyra:	Bardhë, Gri
Konsumi:	3-5 kg/m ²
Magazinimi:	Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri
Koha e magazinimit:	12 muaj nga data e prodhimit
Masa vëllimore:	1.6-1.7 gr/cm ³
Reaksioni ndaj zjarrit:	Klasa A1
Ujë për përzierjen:	6-6.5 litra ujë për 25kg
pH i përzierjes:	13
Temperatura e aplikimit:	+5°C deri në +35°C
Koha e korigjimit:	30 minuta
Mbushja e fugave në dysheme:	Pas 24 orësh
I shkelshëm:	Pas 24 orësh
Forca ngjitëse pas 28 ditësh (kushte normale):	≥ 0,5 N/mm ²
Forca ngjitëse pas zhytjes në ujë:	≥ 0,5 N/mm ²
Forca ngjitëse në nxehtësi:	≥ 0,5 N/mm ²
Forca ngjitëse pas 20 minutash:	≥ 0,5 N/mm ²
Forca ngjitëse pas cikleve ngrirje-shkrirje:	≥ 0,5 N/mm ²
Rrëshkitshmëria:	≤ 0.5 mm